

## E. MBIKËQYRJA NË VEND

### 1. INSPEKTIMET E KRYERA GJATË VITIT 2010 DHE PROBLEMATIKA E TYRE

Struktura e re organizative, efektive nga janar 2010 kishte si qëllim integrimin e një linje mbikëqyrëse me këndvështrim horizontal të sistemit bankar me atë në këndvështrimin vertikal, për secilën bankë në veçanti. Funkzioni i mbikëqyrjes në vend, është konceptuar si përgjegjësi e Zyrës së Menaxherëve të Portofolit, përgjegjës për vlerësimin e profilit të rrezikut të subjekteve mbikëqyrëse në portofolin e tyre, në bashkëpunim me sektorët e profilizuar sipas rreziqeve.

Gjatë vitit 2010, subjektet e licencuara kanë qenë objekt i ekzaminimeve, që kanë vlerësuar të gjitha tipet e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet subjekti. Një fokus i veçantë i është dhënë vlerësimit të cilësisë së portofolit të kredisë si dhe mjaftueshmërisë së fondeve rezervë të krijuara për mbulimin e humbjeve nga ky portofol. Në vijim të problematikave të konstatuara, janë organizuar takime me drejtues të lartë të bankave, aksionerët e tyre apo dhe me palë të treta si auditorët e jashtëm të bankave.

#### 1.1. INSPEKTIME TË KRYERA GJATË VITIT 2010

Tabelë 38. Inspektimet e kryera gjatë vitit 2010.

Lloji i institucionit financiar	Ekzaminime të kryera
Banka	3 ekzaminime të plota 6 ekzaminime tematike
Institucione financiare jobanka	4 ekzaminime të plota

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kryerja e ekzaminimeve në vend është bërë e mundur nëpërmjet koordinimit të burimeve njerëzore të sektorëve të profilizuar sipas rrezikut, duke pasur parasysh rëndësinë e problematikave apo fenomeneve të shfaqura në banka të veçanta. Gjatë vitit 2010 janë kryer 3 ekzaminime të plota dhe 6 ekzaminime tematike të bankave të nivelit të dytë si dhe 4 ekzaminime të plota të subjekteve financiare jobanka.

## 1.2. PROBLEMATIKA NGA INSPEKTIMET E SUBJEKTEVE BANKARE

Gjatë vitit 2010 në sistemin bankar kanë vazhduar të shfaqen efektet e rritjes së shpejtë të portofolit të kredisë në vitet e mëparshme, ndikuar edhe nga ngadalësimi i rritjes ekonomike në dy vitet e fundit. Gjatë ekzaminimeve të plota e të targetuara, vëmendje i është kushtuar veçanërisht:

- cilësisë së portofolit të kredisë dhe praktikave të ndjekura nga bankat për monitorimin dhe ndjekjen e kredive në vonesë, si dhe masave të marra për rikuperimin e tyre;
- transparencës së bankave ndaj klientëve në procesin e kreditimit, në drejtim të paraqitjes së një informacioni sa më të plotë mbi termat dhe kushtet e kredive; parandalimit të pastrimit të parave dhe vlerësimit të rrezikut operacional;
- klasifikimit jokorrekt të kredive, jo në përputhje me kërkesat mbikëqyrëse si dhe pamjaftueshmërisë së fondeve rezervë të krijuara nga bankat.

Probleme në zbatimin e rregulloreve. Sistemi bankar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullativ mbikëqyrës. Megjithatë, dobësi janë evidentuar në drejtim të administrimit të rrezikut të kredisë, të ekspozimit ndaj rreziqeve të mëdha, të rrezikut të likuiditetit, transparencës me klientin etj..

Më konkretisht, janë evidentuar raste në të cilat nuk janë respektuar:

- Rregullorja “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”. Gjatë vitit 2010, janë evidentuar tejkalime të ekspozimit maksimal të lejuar prej 10 për qind ndaj kapitalit rregullator për personat e lidhur me bankën si dhe kufirit prej 20 për qind të kapitalit rregullator ndaj një personi ose personave të lidhur me të.
- Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë” lidhur me klasifikimin korrekt të kredive dhe pamjaftueshmërinë e fondeve rezervë të krijuara. Ekzaminimet kanë kërkuar krijimin e fondeve shtesë për provigjione në shuma që variojnë sipas rasteve të bankave specifike. Janë rekomanduar përmirësime në analizat financiare të kredimarrësve si dhe praktikave të ndjekura në monitorimin e performimit të kredisë. Krahas këtyre, janë kërkuar përmirësime të vazhdueshme të politikave dhe procedurave të brendshme që rregullojnë aktivitetin kredihënës.
- Rregullorja “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”. Rritja e fondit të provigjioneve të kërkuara nga grupet e ekzaminimit ka ndikuar në rrillogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, duke rezultuar në tregues me vlerë më të ulët. Përpos kësaj, pasaktësi kanë rezultuar edhe në zbatimin e kërkesave për kategorizimin e aktiveve sipas klasave të rrezikut, megjithëse nuk kanë pasur rëndësi materiale.

- Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”. Rekomandimet lidhur me respektimin e kërkesave të kësaj rregulloreje kanë të bëjnë me respektimin e kufirit rregullator të treguesit të likuiditetit si dhe me ndërtimin e skenarëve të stresuar për vlerësimin e rrezikut të likuiditetit në situata jonormale të zhvillimit të aktivitetit të bankës.
- Rregullorja “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”. Rastet e evidentuara i referohen mungesës në kontratat e kredive e depozitave të disa prej elementeve të parashikuara në këtë rregullore, paqartësisë së informacionit në materialet promovuese, llogaritjes së normës efektive të interesit, ndryshimit të normës së interesit për kreditë etj..
- Rregullorja “Për veprimtarinë valutore”, lidhur me përcaktimin e qëllimit të transfertave dhe dokumentacionin mbështetës.
- Rregullorja “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”. Rastet e evidentuara lidhen me mënyrën e ndërtimit të profileve të përdoruesve, të cilat nuk janë gjithmonë në përputhje me përshkrimin e vendit të punës. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në drejtim të vlerësimit të rrezikut dhe dokumentimit të tij, vlerësimit të shërbimeve të TIK, planit të vazhdimësisë së punës dhe të rikuperimit në rast fatkeqësie etj.. Disa banka gjatë vitit kanë qenë në proces të përmirësimit të programeve të tyre bankare, për të cilat është rekomanduar marrja e masave për respektimin e të gjitha kërkesave të rregullores së mësipërme gjatë implementimit të ndryshimeve të tyre.
- Rregullorja “Për funksionimin e Regjistrimit të Kredive në Bankën e Shqipërisë” lidhur me klauzolën e pëlqimit paraprak që duhet të firmoset nga klienti, si dhe saktësinë e informacionit të raportuar sipas skedarëve etj..

### 1.3. PROBLEMATIKA NGA INSPEKTIMET E SUBJEKTEVE JOBANKA

Ekzaminimet që janë kryer gjatë vitit 2010 në subjektet financiare jobanka kanë pasur në fokus vlerësimin e aktivitetit kreditues të tyre, si dhe hapat e ndërmarrë për administrimin e rrezikut të kredisë. Rëndësi i është kushtuar edhe fushave të tjera si përputhshmërisë, pastrimit të parave, transparencës dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Ndër problemet kryesore të evidentuara mund të përmendim:

- Mosrespektimin e kuadrit të brendshëm të subjekteve. Problemet shfaqen kryesisht në drejtim të respektimit të kufirit dhe miratimit të kredisë, monitorimit të vazhdueshëm të tyre, procesit të ristrukturimit, kategorive të klasifikimit të portofolit, nivelit përkatës të provigjoneve, si edhe bllokimit të kolateraleve të vendosura si garanci. Gjithashtu,

subjektet duhet të rishikojnë dhe të përditësojnë manualët e kredisë, në përputhje me kërkesat rregullative të Bankës së Shqipërisë.

- Mosrespektimin e rregullores “Për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare” në lidhje me pozicionet e hapura valutore si dhe kufijtë e lejuar për ekspozimet e mëdha. Për rastet e evidentuara është kërkuar të merren masa për sjelljen në normë të ekspozimit.
- Transparencën jo të plotë lidhur me informacionin paraprak mbi kushtet e kredisë, duke përfshirë ndër të tjera edhe normën nominale vjetore të interesit; informacion jo të plotë në lidhje me rrezikun e huamarrjes në valutë, kushtet e llogaritjes dhe ndryshimit të normave të interesit dhe metodologjitë e përdorura për llogaritjen e tyre. Mangësi shfaqen edhe gjatë llogaritjes, publikimit dhe raportimit të normës efektive të interesit dhe plotësimit të kontratave me elementet e përcaktuara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë.
- Mangësitë në zbatimin e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- Zgjerimin e fushës së kontrollit të Kontrollit të Brendshëm me verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore të Bankës së Shqipërisë.
- Përmirësimin e politikave, procedurave dhe standardeve teknologjike që lidhen me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit.

#### 1.4. INSPEKTIME TË KRYERA GJATË VITIT 2010 LIDHUR ME PPP/PFT DHE TRANSPARENCËN DHE PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT

Në vitin 2010, gjatë inspektimeve në vend në pesë banka dhe në katër subjekte financiare jobanka, objekt kanë qenë edhe çështjet e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Parandalimit të Financimit të Terrorizmit si dhe Transparencës dhe Publikimit të Informacionit.

Për sa i përket këtyre aspekteve, cilësojmë se sistemi bankar përgjithësisht ka vepruar konform kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë.

Si nga inspektimet në vend të kryera gjatë vitit 2010, ashtu edhe nga analizat periodike nga jashtë në bankat dhe subjektet financiare jobanka, ka rezultuar se institucionet kanë ngritur strukturat dhe infrastrukturat e nevojshme në funksion të PPP/PFT si dhe kanë kompletuar kuadrin e brendshëm rregullativ të nevojshëm në këtë fushë. Nga ana tjetër, kanë mundur gjenerimin çdo ditë të të gjitha transaksioneve në para fizike mbi 1.5 milionë lekë dhe transaksioneve jo në para fizike mbi 6 milionë lekë, si dhe kanë kryer trajnimet e nevojshme për punonjësit për çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Megjithatë, gjatë inspektimeve në vend janë evidentuar edhe mangësi kryesisht në lidhje me implementimin e programeve që mundësojnë qartë parametrat e perceptimit të riskut sipas natyrës së aktivitetit të biznesit, pozicionimit të klientit, volumit të xhiros, gjendjes shoqërore dhe financiare etj.; funksionimin e sistemit të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave; rritjen e frekuencës së kontrolleve të brendshme si dhe cilësisë së këtyre kontrolleve. Nga ana tjetër, kemi rekomanduar rritjen edhe më shumë të numrit të trajnimeve për stafin si dhe fokusimin e tyre në çështje specifike të sistemit bankar. Një moment që kërkon ndjekje të vazhdueshme nga strukturat përgjegjëse në banka është edhe raportimi i aktivitetit të dyshimtë si në tregues sasiore (numri i ulët i tyre) ashtu dhe në treguesit cilësorë (analizimin e tipologjive) si dhe përcaktimi jo i mjaftueshëm i kategorive të transaksioneve ndaj të cilave ushtrohet vigjilenca e zgjeruar.

Përsa i përket transparencës dhe publikimit të informacionit, gjatë vitit 2010 bankat në mënyrë individuale kanë përshtatur si infrastrukturën rregullative ashtu edhe atë operacionale për të qenë në përputhshmëri me rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Më konkretisht, në përgjithësi, kanë vepruar në përputhje me rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët" si dhe rregulloren "Për plotësimin e kërkesave minimale të publikimit të informacionit nga bankat". Në këtë drejtim, dallohet një rritje e cilësisë në raportimin e Normës Efektive të Interesit (NEI) pranë Bankës së Shqipërisë si dhe të formateve me informacion parakontraktor për kreditë, megjithëse ende ka raste ku vërehen mangësi në dhënien e informacionit paraprak klientëve, gjatë procesit kreditues si dhe me publikimin e NEI-t. Cilësojmë se bankat kanë qenë bashkëpunuese në drejtim të përmirësimit të kontratave të kredive, ndërkohë që duhet të jenë më të kujdesshme në njoffimin e klientëve në rastet e ndryshimit të kushteve të ofrimit të produkteve.

Në kuadrin e publikimit të informacionit vihen re gjithashtu, përmirësime. Është reduktuar numri i bankave që nuk kanë faqe zyrtare interneti dhe cilësia e publikimeve në to është rritur. 14 nga 16 bankat e sistemit janë pajisur me faqe zyrtare interneti pjesa më e madhe e të cilave ka një nivel bashkëkohor me informacion të gjithanshëm mbi veprimtarinë e tyre.

Në subjektet financiare jo-banka, vihen re përpjekje të kënaqshme për të arritur përputhshmërinë me kërkesat rregullative përkatëse të Bankës së Shqipërisë.

#### 1.5. INSPEKTIME TË KRYERA PËR VERIFIKIMIN E KUSHTEVE OPERACIONALE TË SUBJEKTEVE

Gjithashtu, gjatë gjithë vitit janë ushtruar inspektime në vend për verifikimin e kushteve operacionale të subjekteve që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në ambiente të reja apo që kërkojnë të licencohen nga Banka e Shqipërisë në përputhje me kërkesat e nenit 14, pika 7 të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja

në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenit 18, pika 1 të rregullores “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtari bankare dhe financiare”.

Gjatë vitit 2010 janë inspektuar në përputhje me kërkesat regullative përmendur më lart:

- 66 zyra këmbimi valutor;
- 19 degë të reja bankash;
- 4 subjekte të reja financiare jobanka.

## 2. BASHKËPUNIMI ME AUTORITETE TË TJERA

### 2.1. BASHKËPUNIMI ME AUTORITETE TË HUAJA

Bashkëpunimi me autoritetet e huaja ka vijuar edhe gjatë vitit 2010. Mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa autoritete mbikëqyrëse të huaja janë përgatitur informacione për banka të caktuara të huaja që zhvillojnë aktivitetet bankar në vendin tonë. Gjithashtu, në vijim të iniciativës së Bankës Qendrore Evropiane për funksionimin e kolegjeve të mbikëqyrësve të institucioneve më të mëdha bankare e financiare evropiane, gjatë vitit 2010, është marrë pjesë në kolegjet e organizuara nga Banka e Greqisë. Këto kolegje shërbyen si një mundësi takimi midis përfaqësuesve të autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të cilat kanë prezencë të grupeve të mëdha bankare greke si dhe përfaqësuesve të menaxhimit të lartë të këtyre grupeve bankare në Greqi. Çështjet e diskutuara në këto kolegje lidhen me problematikat e veçanta të konstatuara në filialet dhe degët e bankave, të evidentuara gjatë zhvillimit të procesit mbikëqyrës nga autoritetet përkatëse, masat e marra për adresimin e tyre si dhe sfidat për të ardhmen. Ndërkohë, edhe në kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave ka patur bashkëpunim me banka qendrore të vendeve të huaja.

### 2.2. BASHKËPUNIMI ME AUTORITETE TË TJERA NË VEND

Përgjatë vitit 2010 Banka e Shqipërisë ka vijuar bashkëpunimin eficient me institucione të ndryshme të cilat monitorojnë aktivitetet të veçanta të tregut financiar në vend. Më konkretisht, janë shkëmbyer informacione dhe janë kryer inspektime të përbashkëta në banka me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me objekt shoqëritë e sigurimeve në sistemin bankar.

Ka patur një bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Ky bashkëpunim nuk është kufizuar vetëm në raportimin periodik tremujor në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) mbi zbatimin e dokumentit strategjik për hetimin e krimit financiar, por ka përfshirë edhe një shkëmbim korrespondence të shpeshtë gjatë gjithë vitit midis Bankës së Shqipërisë dhe DPPPP-së. Departamenti i Mbikëqyrjes ka qenë i pranishëm në takimet periodike

të grupit të ekspertëve për raportimin e planit të zbatimit të dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Hetimin e Krimit Financiar, pjesë e rëndësishme e të cilit është edhe puna institucionale për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Ky dokument i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr.1077, datë 27.10.2009, synon të krijojë një platformë afatgjatë veprimi dhe të vendosë një ekuilibër ndërmjet parandalimit efektiv dhe hetimeve të krimeve në fushën ekonomiko - financiare. Institucionet shtetërore të përfshira në zbatimin e tij, ku bën pjesë edhe Banka e Shqipërisë do të vendosin standarde, bazuar në respektimin e vlerave si: integriteti, përkushtimi dhe profesionalizmi.

Bashkëpunimi lidhur me parandalimin e pastrimit të parave për vetë rëndësinë që mbart edhe për institucione të tjera të mbrojtjes së ligjit, nuk është kufizuar vetëm me DPPPP-në, por ka përfshirë edhe një shkëmbim korrespondence të shpeshtë gjatë gjithë vitit midis Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve të tjera si Ministria e Financave, Shoqata Shqiptare e Bankave, etj..